



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Debat publik për Dëgjimet Buxhetore për vitin 2024 - Fshati Gllamnik

Debatin publik të mbajtur më 22 gusht 2023 në fshatin Gllamnik e filloi Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani, i cili tha se arsyeja e mbajtjes së këtij debati publik është që Komuna e Podujevës tashmë është në fazën e hartimit të buxhetit për vitin 2024 si dhe projeksioneve buxhetore për vitin 2025 dhe 2026. Pjesmarrës ishte edhe Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Leutrim Krasniqi.

Drejtori Osmani i informoi qytetarët se Komuna e Podujevës ka një buxhet të përgjithshëm prej 31 milion e 43 mijë e 19 euro, nga këto 16 milion e 518 mijë e 288 euro janë në kategorinë e pagave, 3 milion e 585 mijë euro në mallra, 530 mijë euro janë shpenzime për komunalitet do të thotë, rrymë, ujë dhe mbeturina dhe qështje tjera që kanë të bëjnë me shërbime komunale. 1 milion e 670 mijë euro janë në kategorinë e subvencioneve dhe 8 milion e 756 mijë e 231 euro janë buxhet i planifikuar për investime kapitale të Komunës së Podujevës.

Komuna e Podujevës i ka të hartuara disa dokumente strategjike siç është Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal si dhe Korniza Afatmesme Buxhetore, ku në këto dy dokumente janë të paraqitura synimet dhe objektivat e Komunës së Podujevës si dhe projektet konkrete.

Gjatë këtyre viteve por edhe në vitet në vijim theksoi Drejtori Osmani Komuna e Podujevës ka disa prioritete strategjike dhe disa projekte prioritare në disa fusha ku janë përqëndruar investimet vlen të ceket edhe fusha e investimeve në arsim, investime në shëndetësi, investime në kulturë, rritjen e subvencioneve në fushën e bujqësisë dhe në fushën e ekonomisë, si dhe rritje në kategori të tjera dhe në programe të tjera.

Po ashtu ka një numër të madh të investimeve kapitale siç është ndërtimi i rrugëve “Skenderbeu” dhe “Xhemajl Mustafa” përgjat lumit llap, madje edhe në projeksione buxhetore është edhe ndërtimi i unazës së qytetit në mënyrë që t’u ipet zgjidhje edhe problemeve të komunikacionit të qytetit dhe probleme të tjera infrastrukturore.

Trajtimin po ashtu e problemeve që kanë të bëjnë me ujërat e zeza, që është pjesë edhe e Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe në buxhetin e vitit 2024 dhe në projeksionet e viteve të ardhshme parashihet që t’i jepet një zgjidhje përfundimtare këtij problemi.

Drejtori Osmani fjalën ua kalon banorëve të fshatit Gllamnik, ku tha se i pranojnë kërkesat dhe ankesat e qytetarëve të komunës së Podujevës sepse në fund kur të votohet buxheti të jetë sa më gjithpërfshirës dhe që të përgjigjet sa më shumë nevojave dhe kërkesave të qytetarëve. Megjithatë vazhdon ai se përkundër rritjes së buxhetit në vitet e fundit kërkesat janë gjithmonë më të mëdha sesa mundësia për t’i realizuar ato. Idea e këtyre debateve është që të zgjidhen dhe të prioritetohen fushat të cilat kanë rëndësi dhe kërkojnë zgjidhje më të shpejtë. Ndërsa disa

kërkesa që kanë qenë më herët janë realizuar dhe disa tjera janë në proces, ndërsa pjesa tjetër do të bëhet përpjekje maksimale që të inkuadrohen në buxhetin e vitit 2024, mirëpo për sinqeritet nuk mund të inkuadrohen të gjitha thotë Drejtori Osmani.

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Leutrim Krasniqi – tha se ndarja buxhetore për vitin 2024 do të bëhet duke marrë për bazë kërkesat e qytetarëve, duke marrë për bazë edhe ndarjet buxhetore që janë për fshatra dhe besojmë se të gjitha kërkesat e nevojshme për fshatin Gllamnik janë të përfshira në Kornizën Afatmesme Buxhetore, e që tash besojmë se do të jenë të përfshira edhe në buxhetin e vitit 2024, për të vazhduar pastaj edhe në vitin 2025 dhe 2026. Dhe kështu u kalohet fjala banorëve të fshatit Gllamnik.

Osman Bahtiri, përfaqësues i fshatit Gllamnik – fjalën e tij e fillon duke potencuar disa nga punët që janë kryer në fshatin Gllamnik kryesisht infrastrukture. Ndërsa ankesat e tij i fillon që nga Qendra e Mjeksisë Familjare ku thotë që është shumë mirë e rregulluar objekti i jashtëm por që mungojnë shërbimet si infuzionat dhe gjërat elementare. Ndërsa në vazhdim ai e përmend edhe shtratin e lumit llap ku thotë se gjatë vërshimeve po shkakton shumë probleme nëpër shtëpi dhe nëpër livadhe, ku më së shumti ka bërë dëme ne lagjen “Kosumi”. Po ashtu kërkesë tjetër është edhe ndërtimi i një ure mbi lumin llap, ku pjesa e fshatit të ketë mundësi të lidhet me livadhet e fshatit. Ndërsa kërkon të hapet edhe një rrugë që lidhë fshatin Gllamnik me fshatin Siboc, i cili njëkohësisht potencon se para shumë kohe ajo rrugë ka qenë e hapur. Rruga tjetër fillon nga lagjia Lahu dhe e lidhë fshatin Buricë dhe Konushec, ku thotë se nuk ka kërkesa për asfaltim por vetëm për rregullim me zhavor sa të bëhet e kalueshme. Një tjetër pjesë e rrugës është ajo në lagjen “Ramoci”, ata gjenden në krye të fshatit Gllamnik, përmbi lagjen “Arbanasht”, ndërsa në anën e majt gjinden disa shtëpi që quhen “Ramost”, dhe ata kanë kërkesë nga organet komunale shtrimin e rrugës pasi që kanë edhe biznese familjare dhe të kenë mundësi ta zhvillojnë . Kërkesa tjetër është për shtrimin e rrugës nga lagjia “Kërrtokt” e cila e lidhë me pjesën tjetër të fshatit, e cila është rreth 300 metra e pashtuar. Rruga tjetër që ka nevojë të shtrohet është rruga nga gjamia e deri te lagjia e “Llapashticëve” ku janë 100-150 metra me zhavor, e lidhë xhaminë e fshatit me varrezat e fshatit me lagjen Kërrtok-Llapashtic. Ndërsa në rrugën e cila kalon nëpër disa lagje dhe kalon në fshatin Siboc vitin e kaluar janë bërë disa rregullime me rrjetin e kanalizimit, ajo rrugë ka prap nevojë për rregullim. Tjetër rrugë janë Obrazhët e ulët që i lidhë me qatë rrugë dhe ka nevojë për rregullim, së paku ta marrin formën e rrugës. Ndërsa për kanalizime janë kryer shumica, ndërsa ka mbet në gjysmë pjesa mbrapa shkollës, janë përfunduar gati 200 metra ndërsa kanë mbetur edhe 100 e më tepër metra për tu lidhur me lagjen “Xhonolli” dhe lagjen “Veliu”, për të përfunduar në kolektorin e ujërave të zeza i cili vjen nga fshati Llapashticë. Kërkesë me radhë është hapja e shtegut i cili thotë se është bllokuar. Kërkesa tjetër është rregullimi i varrezave për arsye se aty afër gjindet dhe një përmendore dhe ka vizitorë kohë pas kohe. Në vazhdim flitet edhe për hapjen e nënkalimit për të mundësuar kalimin e nxënësve për të shkuar në shkollë dhe jo vetëm. Problematikë tjetër që përmendet është edhe rregullimi i rrethrotullimit në qendër të fshatit, i cili ndihmon edhe rregullimin e komunikacionit dhe eviton edhe aksidentet e mundshme që nuk janë të pakëta. Megjithatë ani pse e përmend që shumë banorë nga fshati Gllamnik kanë qenë përfitues të subvencioneve komunale në aspekte bujqësore, prap vërshimet i kanë dëmtuar dhe kërkojnë kompenzimin e tyre. Ndërsa kërkesë e shkollës është ndërtimi i një salle sportive, ndërsa kërkesa ka edhe për ndërtimin e një çerdheje për fëmijë.

Hysen Hyseni, banor i fshatit Gllamnik – kërkesa e tij fillon për rrugën e cila thotë se ka qenë duke u rregulluar që në vitin 2012 ndërsa është ndërprerë, dhe 421 metra kanë mbetur të pa rregulluara, ku gjindemi 4 shtëpi. Sepse mos rregullimi i kësaj rruge po dëmton edhe zhvillimin e biznesit, ku thotë se e ka dëmtuar në biznesin e tij me mjedrra, dhe po e dëmton edhe në përpjekjen e tij për të hapur biznes të rinjë për shumimin e peshkut. As kanalizimi nuk ka arritur të afrohet afër shtëpive tona, dhe kanalizimi derdhet në ara shprehe pakënaqësinë e tij, duke kërkuar që sa më shpejt të rregullohen.

Banor i fshatit Gllamnik – Ka kërkesë për shtrimin e rruges në lagjen “Ramosaj”, pasi që rruga është shumë e keqe.

Banor i fshatit Gllamik - Bënë pyetje për rregullimin e trafikut urban në Podujevë, nëse është në plan këtë vit.

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Leutrim Krasniqi – Përgjigjet e tij i fillon me problematiken e rregullimit të shtratit të lumit llap, ku thotë se Komuna ka një kontratë tashmë për pastrimin e lumit llap, por që kjo kontratë vlen vetëm për pjesët ku parashihet se mund të shkaktojnë dëme nga vërshimet aktuale. Ku kemi bërë kërkesë në Ministri për mbështetje financiare për zgjerimin apo rregullimin e shtratit të lumit llap, sidomos në pjesën e fshatit Gllamnik, Siboc i Poshtëm dhe një pjesë e fshatit Lluga. Ndërsa për urën mbi lumin llap drejtorja e ka marrë si kërkesë dhe e ka shqyrtuar komisioni përkatës rreth vlerës investive për pjesën tjetër të buxhetit që ka komuna dhe ka marrë një përfundim në kuadër të kësaj kërkesë. Për rregullimin e murit mbrojtës, besojmë që është adresuar në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, dhe është një kontratë që është proceduar në prokurim dhe besohet që do të jetë prioritet. Ndërsa për rrugët që u përmenden thotë që do të mundohen të gjitha të përfshihen por gjithmonë duke marrë parasysh edhe limitet buxhetore të cilat janë të përcaktuara edhe për pjesën e infrastrukturës, në veçanti edhe tek Korniza Afatmesme Buxhetore për infrastrukturën në Gllamnik është përfshirë rruga të cilën e përmendi Hysen Hyseni (banor i fshatit Gllamnik). Ndërsa kërkesat për rregullimin e varrezave dhe disa pjesë rreth kanalizimeve besoj që janë diskutuar në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike gjithashtu. Një gjë tjetër me rëndësi janë edhe pjesa e rrathëve në rrugën magjistrale të cilët janë në procedurë të vonuar, e kemi ngritur si shqetësim që në procedurë sa më të shpejt të zgjidhet edhe kjo qështje, por dihet që jo në çdo lagje por aty ku është më e nevojshme. Por gjithsesi po shpresojmë që edhe ju jeni të kënaqur nga puna e deritanishme që është bërë në fshatin Gllamnik.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani – si fillim falenderoi qytetarët për bashkëbisedimin dhe tha se pa dyshim të gjitha kërkesat e tyre janë të arsyeshme por janë kufizimet buxhetore të cilat shkaktojnë disa probleme. Dhe përkundër rritjes së buxhetit prap nevojat nuk mund të mbulohen të gjitha, mirëpo pa dyshim që ky buxhet duhet të mbulojë çdo fushë të jetës shoqërore dhe ekonomike, Arsim, Shëndetësi, Kulturë, Administrat, mirëpo do të bëjmë përpjekje maksimale që t’u përgjigjemi këtyre kërkesave të cilat i keni. Ndërsa për qështjet e shëndetësisë dhe arsimit objekti i shëndetësisë në fshatin Gllamnik është prej objekteve më të mira Podujevë, aty janë funksionalizu disa shërbime dhe do të funksionalizohen edhe disa tjera, që të ofroj të gjitha shërbimet. Ne e kemi prioritet fushën e shëndetësisë, dhe e kemi prioritet furnizimin me medikamente, dhe është i mbuluar me buxhet të mjaftueshëm. Ndërsa për kërkesat për ndërtimin e sallës së edukatës fizike, ne kemi bërë një kërkesë në nivelin qëndror përkatësisht në Ministrinë e Arsimit për ndërtimin e sallave sportive në fshatin Gllamnik, dhe besojmë se do të ndërtohet, dhe në rast se Ministria nuk e përfshinë në vitin 2024,

ne e kemi në buxhet për vitin 2025. Po ashtu edhe për çerdhe, Qeveria e Republikës së Kosovës ka prioritet ndërtimin e çerdheve në të gjithë Kosovën dhe shpresojmë shumë që gjatë këtyre dy viteve do të ndërtohet një çerdhe në Gllamnik. Ndërsa do të hapen edhe disa qerdhe në Lluzhan dhe në Sfeqël, ndërsa pritet të filloj ndërtimi edhe në fshatin Batllavë dhe çerdhja e dytë në qytetin e Podujevës. Do të ketë edhe investime në shkollë, për nevojat tjera të shkollës.

Deri në fund të muajit shtator jemi të gatshëm për kërkesat e juaja, dhe do t'i përmbahemi Qarkores Buxhetore që është ligj për çdo komunë, ku ndahet në bazë të numrit të banorëve dhe sipërfaqes, dhe është ndarje e sakët buxhetore që bëhet nga ana e Ministrisë së Financave. Ne jemi në dispozicion tuaj që të jemi në kontakt të vazhdueshëm, deri në miratimin e buxhetit në Kuvendin Komunal. Shumë projekte do të realizohen në vitin 2024 por disa tjera do të mbesin në buxhetin e vitit 2025.

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Leutrim Krasniqi – i dha përgjigje edhe pyetjes për trafikun urban, pas përfundimit të stacionit të autobusëve do të shqyrtohet nëse do të ketë mundësi që në këtë linjë të përfshihet edhe fshati Gllamnik.

Drejtorët e dy drejtorive i falenderojnë banorët e fshatit Gllamnik për pjesmarrjen dhe këtu mbyllin debatin publik në të cilin pjesmarrës ishin 5 banorë.

22 Gusht / Fshati Gllamnik







[Handwritten signature]



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Dëgjim Publik në Gllamnik për projekt buxhetin e komunës për vitin 2024 -
Lista e nënshkrimeve

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nr.telefonit	Nënshkrimi
1	OSMAN BAHTIMI	Gllamnik		<i>[Signature]</i>
2	HYSEN HYSENAG	Gllamnik		<i>[Signature]</i>
3	NASER LAZA	Gllamnik		<i>[Signature]</i>
4	AVNI HYSEN	OLLAMIK		<i>[Signature]</i>
5	ALTER MUSLILU	Gllamnik		<i>[Signature]</i>
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				

25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				

Gllamnik

22.08.2023